



VENDIM

Nr. 13 Datë 06.02.2012

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “SNOW ENERGY” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “g”, 5 pika 2, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licënsave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.02.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k për licencim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licënsimit dhe Monitorimit të Tregut dhe të të licënsuarve Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licënsimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licënsave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma “a”, ”b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma “a”, ”b”, ”c”, ”d”, ”f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërma “a”, “b” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, gërma “a”, “b”, dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “Snow Energy” sh.p.k në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftoj aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI